

VENDIM
Nr. 108, datë 27.7.2012

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV ME KABËLL ALFA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Sami Nezaq	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Alfa”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 33, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VËREN SE:

Me vendimin nr. 448, datë 27.4.2006, KKRT-ja ka licencuar shoqërinë “Alfa kabëll” sh.p.k., për subjektin televiziv privat kabllor “TV me kabëll Alfa”, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor në fushën e transmetimeve televizive private kabllore për të penetruar në qytetin e Tiranës dhe Shkodrës. Vendimi i KKRT-së për dhënien e licencës ka hyrë në fuqi në datën 10.5.2006 dhe afati i përfundimit të licencës së subjektit ka qenë data 10.5.2012. KKRT-ja me shkresën nr. 419 prot., datë 26.3.2012, ka njoftuar subjektin për përfundimin e afatit të licencës, duke kërkuar nga ky i fundit depozitimin e aplikimit për rinovim licence, si dhe duke i tërhequr vëmendjen për të shlyer detyrimet financiare ndaj KKRT-së, pagesë vjetore për licencë për vitet 2010 dhe 2011. Pavarësisht njoftimit zyrtar të KKRT-së, nga ana e subjektit, nuk është depozituar aplikim për rinovimin e licencës.

KKRT-ja konstaton se subjekti, përveç mungesës së interesit për rilicencim, ka detyrime financiare ndaj KKRT-së, pagesë vjetore për licencë për vitet 2010 dhe 2011, në masën 5.000.000 lekë.

Detyrimet e mësipërme i janë bërë me dije subjektit me shkresat nr. 269 prot., datë 15.2.2010, nr. 64 prot., datë 14.1.2011, nr. 1198 prot., datë 14.9.2010, nr. 647 prot., datë 5.4.2011 dhe nr. 666 prot., datë 5.4.2011. Së fundmi, me shkresën nr. 755 prot., datë 5.6.2012, është ripërsëritur kërkesa për shlyerjen e detyrimeve, duke caktuar si afat përfundimtar datën 15.6.2012.

Në vijim, me shkresën nr. 1054 prot., datë 13.7.2012, KKRT-ja ka njoftuar subjektin televiziv privat kabllor “TV me kabëll Alfa” se në mbledhjen e radhës, në rast mosshlyerje të detyrimeve, do të vijonte me procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit. Gjithashtu, subjekti është njoftuar për të drejtën për t’u dëgjuar, duke marrë pjesë në mbledhje apo duke paraqitur pretendimet mbi çështjen.

Përfaqësuesi i subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Alfa”, z. Eduard Buda, i pranishëm në mbledhje, parashitroi përpara KKRT-së se nuk kishte dijeni lidhur me mungesën e aplikimit për rinovimin e licencës. Përfaqësuesi i subjektit deklaroi se detyrimet financiare ndaj KKRT-së nuk janë shlyer, pasi subjekti parashikon të bëjë një sërë ndryshimesh në strukturën e ortakëve të shoqërisë, në mënyrën e transmetimit dhe pas kryerjes së këtyre ndryshimeve, thekson se do të vijojë me kryerjen e pagesave.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se: “Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. Mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

...

5. Kërkesi... nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj”.

KKRT-ja konstaton se pretendimet e paraqitura nga subjekti, nuk janë të mbështetura në ligj e në prova. Subjekti, siç u parashtrua edhe më lart, është njoftuar shkresërisht për përfundimin e afatit të licencimit

dhe për detyrimet financiare ndaj KKRT-së dhe arsyet e paraqitura nga ana e tij nuk qëndrojnë,

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 dhe nenit 33, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Alfa”, me nr. 007/RTV kabllor.

2. Subjekti televiziv privat kabllor “TV me kabëll Alfa” të ndërpresë menjëherë transmetimin.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja në dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati